



APLIKIMI I TARIFAVE PER VITIN 2015

OSHEE sh.a.

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Adresa : Njësia Nr.5, Rr. “Andon Zako Çajupi”, Pall Conad, Kati III,
Tiranë,
Shqipëri

Përmbajtja

1.PËRMBLEDHJE	5
1.1 Vështrim i Përgjithshëm	5
1.2 Përlllogaritja e Kërkesës për të Ardhura	6
1.3 Përlllogaritja e tarifave të transmetimit.....	7
1.4 Indeksi i çmimit të konsumatorit.	9
1.5 Kursi I këmbimit valutor	9
1.6 Aktivitete në përmirësim të treguesve tekniko-ekonomikë të Kompanisë	10
1.6.1 Përmirësimi i faturimit dhe uljes së humbjeve në vitin 2014.....	10
1.6.2 Përmirësimi i arkëtimeve në vitin 2014.....	10
1.6.3 Përmirësim në Menaxhimin e Rrjetit.....	12
1.6.4 Përmirësime në Llogaritjen dhe Analizën e humbjeve.	13
1.6.5 Përmirësime në Marrëdhëniet me Klientët.....	14
2. PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI	15
2.1 Historiku i të dhënave	15
2.2 Metodologjia e Parashikimit të Energjisë së Injektuar në Rrjetin e OSHEE	16
2.2.1 Energjia e injektuar e parashikuar për vitin 2015	16
2.2.2 Energjia e injektuar për cdo muaj.....	17
2.3 Metodologjia e Parashikimit të Energjisë së Faturuar në Rrjetin e OSHEE për konsumatorët tariforë	17
2.3.1 Parashikimi i energjisë së faturuar për konsumatorët e lidhur në 35Kv ..	17
2.3.2 Formulatat për parashikimin e vitit 2015 sipas kategorisë	18
2.4 Parashikimi i energjisë së faturuar për konsumatorët e lidhur në 20/10/6 Kv	19
2.5 Parashikimi i energjisë së faturuar për nivelin e tensionit 0.4 kv.....	20
2.5.1 Parashikimi i energjisë së faturuar për 3mujorët e mbetur të 2014	21
2.6 Konsumatorët Familjarë	22
2.7 Metodologjia e përdorur për llogaritjen e Grad ditët	22
2.8 Përmbledhje e fakteve më të afërta të historikut të të dhënave	28
3. PËRLLLOGARITJA E SHPENZIMEVE OPERATIVE (OPEX)	28
3.1 Përmbledhje për shpenzimet operative	28
3.2 Shpenzime materiale dhe konsumi.	30
3.3 Shpenzime për personelin	30
3.4 Shpenzimet për Mirëmbajtje	31
3.5 Penalitete dhe Gjoha.	31
3.6 Shërbime korporate	32

Departamenti Ekonomik

Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit

3.7	Marrëdhënie me Publikun dhe Marketing	32
3.8	Shpenzime për Qera	32
3.9	Shërbime Postare dhe Komunikimi	32
3.10	Shpenzime të Teknologjisë së Informacionit	33
3.11	Shpenzime Ligjore	33
3.12	Konsulecë dhe Auditim	33
3.13	Shpenzime të tjera	33
4.	ASETET BAZE TE RREGULLUARA.....	34
4.1	Investimet (CAPEX)	34
4.1.1	Vështtrim i përgjithshëm	34
4.1.2	Mosrealizimi për vitin 2011	35
4.1.3	Mosrealizimi për vitin 2012	35
4.1.4	Realizimi i investimeve për vitin 2013	36
4.1.5	Realizimi i investimeve për vitin 2014	37
4.1.6	Plani i investimeve për vitin 2015	38
4.2	Amortizimi	39
4.3	Kapitali i punës	43
4.4	Përlllogaritja e Aseteve Baze të Rregulluara.....	44
5.	PËRLLLOGARITJA E NORMËS SË INTERESIT TË BORXHIT.....	44
6.	PËRLLLOGARITJA E PESHËS MESATARE TË PONDERUAR TË KOSTOS SË KAPITALIT (WACC)	46
7.	PËRLLLOGARITJA E TË ARDHURAVE TË KËRKUARA PËR SHPËRNDARËSIN E ENERGISJË ELEKTRIKE	47
8.	PËRLLLOGARITJA E TË ARDHURAVE TË KËRKUARA PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME PAKICË	48
8.1	Shpenzimet operacionale	48
8.2	Kosto e Transmetimit.....	48
8.3	Marzhi i fitimit.....	48
8.4	Kompensimi për Borxhin e Keq.....	48
8.5	Kompensimi për TVSH e humbjeve	49
8.6	Të ardhura nga Lidhjet e Reja dhe Energjia Reaktive	50
8.7	Përlllogaritja e tarifës për Furnizuesin Publik me Pakicë.....	50
9.	PROPOZIMI PËR TARIFË MESATARE TË SHITJES NGA OSHEE	51
10.	TË TJERA.....	51
11.	LLOGARITJA E TARIFAVE PËR LLOJET E KONSUMATORËVE	52
12.	PËRLLLOGARITJA E TARIFËS PËR NIVEL TENSIONI.	55
12.1	Përlllogaritja e shpenzimeve operative	55
12.2	Kosto e humbjeve	56

Departamenti Ekonomik

Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit

12.3 Vlera e Aseteve Bazë të Rregulluara dhe Përlogaritja e Peshës Mesatare Të Ponderuar të Kostos së Kapitalit	56
12.4 Përlogaritja e të ardhurave të kërkuar për nivel tensioni dhe tarifës	56
SHTOJCAT.....	58

1. PËRMBLEDHJE

Me këtë dokument paraqesim aplikimin për tarifën e reja të shitjes së energjisë dhe të transmetimit në rrjetin e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) për vitin 2015.

1.1 Vështrim i Përgjithshëm

Detyrimi ligjor për përlogaritjen e kërkesë për tarifë e gjen kompaninë OSHEE në fazën e përpjekjeve të gjithanshme për transformimin dhe ringritjen ekonomike. Administrimi i ri i kompanisë OSHEE (vazhdim i CEZ Shpërndarje) që fillon nga muaji Tetor 2013 e gjeti atë në një situatë financiare të rrënuar. Kështu totali i detyrimeve të kompanisë kishte arritur në shifrën e frikshme të 91 miliard Lekëve dhe gjendja në kapitalin e vet ishte (- 53) miliard lekë.

Gjatë kësaj periudhe të thujse 1 viti administrimi jemi përpjekur pa u lodhur të ringremë nga rrënimi total kompaninë nëpërmjet uljes së humbjeve nga shitja e energjisë dhe përmirësimit të arkëtive, por e kemi të pamundur të eliminonim shpenzime që janë pasojë e detyrimeve që rrjedhin nga dështimi në marrëdhëniet kontraktuale të administrimit të kaluar, sidomos të periudhës para vitit 2012. Vetëm në Dhjetor 2013 jemi penalizuar nga KESH dhe organet tatimore për rreth 6 miliard Lekë, që së bashku me kërkesën për pagimin e tatimit prej rreth 1 miliard Lekë dhe me vendimin për të mos marrë parasysh vlerësimin e mëparshëm për sasinë e energjisë së pafaturuar me një efekt prej 2 miliard Lekë, i shtuan humbjes menaxheriale prej 18 miliard Lekë edhe 9 miliard Lekë të tjera për të arritur në 27 miliard Lekë humbje gjithsej.

Gjatë vitit 2014 treguesit ekonomik – financiarë të kompanisë si rezultat i uljes së humbjes, rritjes së arkëtive janë përmirësuar ndjeshëm, por megjithatë si pasojë e targetit të paarrtshëm të humbjeve përcaktuar në periudhën e mëparshme rregullatore mund vetëm ta përmirësojnë atë, por jo ta frenojnë tërësisht.

Mosndryshimi i treguesve të synuar të lartë si niveli i humbjeve të njohura nga ERE prej 19.92% në vitin 2013 dhe 16.92% në vitin 2014 me të cilën u llogarit edhe tarifa e shitjes së energjisë për periudhën rregullatore 2012-2014 vazhdon të thellojë humbjen financiare të kompanisë. Ndërkohë që në Janar 2013 kur ERE mori vendimin për të kaluar shoqërinë në administrim të përkohshëm humbjet nga shitja e energjisë ishin 48% dhe në fund të vitit 2013 ishin 45%.

Gjatë vitit 2014 synojmë uljen e humbjeve në 39% (38.69% për periudhën Janar – Shtator), por humbja financiare megjithëse e ngadalsuar ndjeshëm vazhdon të thellohet. Kështu këtë vit parashikojmë që duke llogaritur edhe penalitetet e mundshme humbja financiare të arrijë në rreth 18 miliard lekë nga të cilat rreth 9

Departamenti Ekonomik

Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit

miliard të parashikuara për penalitete dhe gjoba. Vetëm gjatë periudhës Janar-Gusht 2014 organet tatimore kanë kërkuar penalitete prej 1.1 miliard Lekë kryesisht për mospagim të tatimit fitimit të vitit 2013, të cilin megjithëse kompania rezultoi me humbje shumë të madhe duhet ta paguante.

Sa më lart, kompania ka grumbulluar humbje financiare të jashtëzakonshme të cilat krijojnë kosto historike të papërballueshme nga çmime të llogaritura mbi bazën e parametrave të tregut. Për pasojë vetë kosto e borxhit është e mjaftueshme për të çuar kompaninë në rrënim të mëtejshëm dhe për të bërë në një të ardhme shumë të afërt të pazbatueshëm gati çfarëdolloj çmimi të ndërtuar qoftë edhe mbi baza pragmatiste.

1.2 Përlllogaritja e Kërkesës për të Ardhura

Përlllogaritja e kërkesës për aplikim bazohet në legjislacionin në fuqi sipas Deklaratës Rregullore seksioni 1.3 dhe zbaton të gjitha parimet e vendosura në deklaratë për këto përlllogaritje.

Në zbatim të metodologjisë e cila bazohet në përlllogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara për vitin 2015 kemi marrë në konsideratë supozimet themelore si vijon:

- i. Përlllogaritja e çmimit në zbatim të ligjeve në fuqi nuk ka marrë parasysh gjendjen tejet të vështirë financiare të trashëguar nga kompania. Në përlllogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara nuk janë llogaritur humbjet e viteve të mëparshme që kanë rritur skajshëm detyrimet e kompanisë dhe as pagesat për detyrimet ligjore që kanë lindur nga mospërmbushja në kohë e këtyre detyrimeve.
- ii. Çmimet për Furnitorin Publik me Shumicë dhe OST me të cilat KESH dhe OST i shesin energji dhe transmetim OSHEE janë të njëjta me ato të vitit në vazhdim 2014 dhe nuk kanë asnjë efekt të shtuar në përlllogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara si për Shpërndarjen ashtu edhe për Shitjen e Energjisë nga OSHEE si Furnitor Publik me Pakicë.
- iii. Çmimi i energjisë për mbulimin e humbjeve bazohet në parashikimin sipas monitorimit të nevojës aktuale të tregut dhe që mund të ndryshojë duke u llogaritur si kompensim në vitet e ardhshme të përlllogaritjes së tarifave të energjisë.
- iv. Përlllogaritja e kërkesës për energji është bazuar gjithashtu në treguesit aktualë dhe parashikimin për vitin e ardhshëm por që në varësi të ndryshimeve në treg mund të jetë gjithashtu objekt i kompensimeve për diferenca në vitet e ardhshme.

Departamenti Ekonomik

Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit

- v. Zhvillimet pozitive të ekonomisë Shqiptare janë marrë parasysh në mosllogaritjen e ndonjë faktori jo pozitiv në provigjone të mundshme për efekte të raporteve të paqëndrueshme inflative të ekonomisë që mund të përkthehet në rreziqe të rritjes së menjëhershme të mospagesave nga klientët tanë.

Sasia e energjisë së injektuar në sistem për vitin 2015 parashikohet të jetë 7,100 GWH. Sasia e energjisë së shitur parashikohet të jetë 4,544 GWH dhe sasia e energjisë për mbulimin e humbjeve parashikohet të jetë 2,556 GWH duke parashikuar që niveli i humbjeve të jetë 36%.

Mungesa e investimeve e ka çuar tashmë rrjetin e shpërndarjes së energjisë drejt rrënimt dhe nevoja për investime është shumë e madhe. Kjo nevojë lidhet jo vetëm me përmirësimet teknologjike të nevojshme në drejtim të cilësisë së shërbimit, por shpesh thjesht dhe vetëm me zëvendësimin e makinerive dhe paisjeve të cilat kanë mbaruar tërësisht ciklin e jetës. Këto nevoja përcaktojnë një periudhë të gjatë strategjike investimi për të cilin viti 2015 do të jetë vit i fillimit. Mbështetja kryesore për investimet në vitet e ardhshme mbetet financimi me ndërhyrjen e Bankës Botërore. Investimet për vitin 2015 mbështetur në këtë kredi dhe në burime të brendshme të kompanisë do të jenë 5.5 miliard Lekë.

Administrimi i ri i ka kushtuar rëndësi të madhe kursimit për çdo zë të shpenzimeve. Shpenzimet operative të planifikuara në aplikimin për tarifë të vitit 2015 janë rreth 23% më të ulta se ato gjatë aplikimit të mëparshëm nga kompania CEZ. Kosto e humbjeve dhe detyrimeve të trashëguara ka sjellë shpenzime dhe penalitete të cilat rëndojnë shpenzimet operative të kompanisë të cilat pavarësisht metodologjisë do të duhet të pranohen si shpenzime operative të paktën pjesërisht.

Borxhi i keq i llogaritur bazuar në Deklaratën Rregullatore dhe legjislacionin fiskal është llogaritur duke mesatarizuar të dhënat e detyrimeve në sistemin billing për periudhën deri në Gusht 2014. Duhet theksuar se megjithëse i njohur nga ERE sipas përlllogaritjes në Korrik 2011 ai nuk është njohur akoma nga organet tatimore për rimbursim të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.

Nga përlllogaritjet si më poshtë kërkesa për të ardhura në vitin 2015 kap shifrën e rreth 30.3 miliard Lekë për të ardhurat e shpërndarjes dhe 24.3 miliard Lekë për të ardhurat për shitjen ose 54.7 miliard Lekë gjithsej.

1.3 Përlllogaritja e tarifave të transmetimit

Përlllogaritja e tarifës së transmetimit kryhet për herë të parë nga kompania OSHEE pasi nuk ishte llogaritur asnjëherë më parë. Duhet theksuar se metodologjia për llogaritjen e tarifës së transmetimit e përgatitur nga ERE kryesisht për OST dhe është shumë pak e

Departamenti Ekonomik

Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit


zbatueshme për OSHEE, prandaj edhe kjo llogaritje është e vështirë dhe bazohet kryesisht në koeficientë të gjetur të alokimit të shpenzimeve dhe jo në matjen e tyre të drejtpërdrejtë sepse:

- i. Rrjeti i shpërndarjes së energjisë është i rrënuar dhe si i tillë është gati e pamundur të përcaktohen qartë kostot oportune të investimeve të nevojshme për sjelljen e tij në parametra të transmetimit cilësor, prandaj përlllogaritja e kostos së transmetimit për nivel tensioni mund të përmbajë në çdo kohë koeficientë shumë të lartë të përafrimit të cilët mund të jenë të papranueshëm.
- ii. Vetë rrjeti i shpërndarjes së energjisë si pasojë e mungesës së vazhdueshme të investimeve, ndërhyrjeve gjithmonë në kushtet e emergjencave është shumë i paqartë qoftë në përcaktimin e humbjeve për çdo nivel tensioni ashtu edhe për ndarjen sipas peshës specifike të përdorimit të tij nga paisjet sipas nivelit të tensionit.
- iii. Sistemi i informacionit (marrjes së të dhënave) për kostot e drejtpërdrejta dhe ato që do të duhet të alokohen në programin financiar SAP nuk është ndërtuar i tillë që të detajojë në mënyrë të qartë këto informacione. Për tu ridetajuar do të duhet kohë dhe përgatitje e posaçme.
- iv. Përlllogaritja e përgatitur më poshtë është mbështetur në Kërkesën për të Ardhura dhe çmimin e shitjes së energjisë për mbulimin e kostove të shpërndarjes.
- v. Të dhënat që zotërojmë janë të pamjaftueshme për të përlllogaritur vlerën e saktë të Aseteve Bazë të Rregulluara (RAB) për nivel tensioni, prandaj për këtë si edhe për Peshën Mesatare të Ponderuar (WACC) kemi përdorur të njëjtat përlllogaritje si ato për të Ardhurat e Kërkuara të Shpërndarjes.
- vi. Ponderimi mbi bazë të energjisë së shitur për nivel tensioni dhe niveli i humbjeve të njohura për cdo nivel tensioni, kanë qenë baza për shpërndarjen e shpenzimeve operative, shpenzimeve për humbjet e energjisë elektrike në rrjet dhe vlerës së Aseteve Bazë të Rregulluara si bazë për llogaritjen e të ardhurave për mbulimin e kostos së kapitalit.

Nga përlllogaritjet duket diferenca e madhe në shpenzimet dhe kërkesën për të ardhura për të mbuluar shpenzimet për nivel tensioni për tensionin 35 kV për 4.33 Lekë /kw, për tensionin 20 kV për 3.66 Lekë /kw, për tensionin 10/6 kV për 6.34 Lekë /kw dhe për për tensionin e ulët për 7.02 Lekë /kw. Megjithatë në rast se raporti i shitjes në bazë tensioni ndryshon, ndryshon edhe baza e shpërndarjes (alokimit) dhe përlllogaritjet duhet të ndryshojnë tërësisht.

1.4 Indeksi i çmimit të konsumatorit.


Referuar të dhënave të Institutit të Statistikave INSTAT janë marrë të dhënat e grafikut të mëposhtëm të cilat tregojnë se indeksi i çmimit të konsumatorit për vitin në vazhdim 2014 tenton të jetë 2%.



Megjithë sa më lart mbështetur në të dhënat shumëvjeçare të Bankës së Shqipërisë si dhe në pritshtësinë sipas normave mbarëeuropiane të inflacionit në përlogaritjet për tarifë kemi konsideruar një koeficient inflacioni prej 3%.

1.5 Kursi i këmbimit valutor

Sipas të dhënave të mëposhtëme të marra nga faqja në internet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit EURO/Lekë dhe tendencës për vitin 2015 kursi i këmbimit për energjinë e importit është marrë 1EURO= 140 Lekë.



1.6 Aktivitete në përmirësim të treguesve tekniko-ekonomikë të Kompanisë

1.6.1 Përmirësimi i faturimit dhe uljes së humbjeve në vitin 2014.

Gjatë periudhës Janar – Shtator 2014 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013 kemi patur një ulje të nivelit të humbjeve prej 4.73% dhe krahasuar me 2012 kemi patur një ulje prej 7.17% të nivelit të humbjeve. (referuar tabelës më poshtë).

Humbjet	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Krahasimi në % 2014 - 2013	Krahasimi në % 2014 - 2012
Humbjet në MWH	2,325,007	2,278,739	2,016,361	(262,378)	(308,645)
Humbjet në %	45.86%	43.42%	38.69%	-4.73%	-7.17%

Përmirësimi ka ardhur nga organizimi dhe ndjekja e punës në terren dhe kontrolli i objektivave të vendosur:

- Ndarja e objektivave në nivel lexuesi
- Monitorimi në bazë ditore i procesit të leximit si dhe i realizimit të planit
- Verifikimi dhe analiza e të gjitha anomalive në bazë ditore
- Ndjekja dhe realizimi i planit në bazë fideri
- Identifikimi, penalizimi i të gjitha rasteve të evidentuara si lidhje të jashtëligjshme

Shumë rëndësi i është dhënë kontrollit dhe përsheptimit të procedurave për hedhjen në sistem të lidhjeve të reja, në mënyrë që të hyjnë në procesin e faturimit gjatë muajit që janë hapur.

Gjatë kësaj periudhe për një përmirësim të vazhdueshëm të situatës, me fillimin e administrimit të ri të OSHEE, janë ndërmarrë një sërë masash lidhur me rastet e dyshuara për lidhje të jashtëligjshme në rrjetin e OSHEE.

Sipas legjislacionit në fuqi, çdo rast i konstatuar nga ana jonë i është dërguar për hetim Prokurorisë. Deri në këto momente kanë arritur në mbi 900 kallëzime penale të bëra nga ana jonë pranë organit të akuzës.

Referuar të njejtës periudhë vlen të përmendet një numër i konsiderueshëm i riparimit dhe mirëmbajtjes të sistemit të matjes për mbi 80,000 abonentë në të gjithë territorin e Shqipërisë.

1.6.2 Përmirësimi i arkëtimeve në vitin 2014.

Gjatë vitit 2014 kemi patur një rritje të lartë të arkëtimit krahasuar me vitin 2013 dhe me vitin 2012.

Departamenti Ekonomik
Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit

Segmente	%	Përqindja e Arkëtimit 2012	Përqindja e Arkëtimit 2013	Përqindja e Arkëtimit 2014	Ndryshim në % 2014 - 2013	Ndryshim në % 2014 - 2012
Total		84%	79%	85%	6.6%	1.2%
Familjarë	%	73%	72%	78%	6.1%	4.8%
Privatë	%	96%	94%	97%	3.0%	1.3%
Buxhetorë	%	85%	74%	75%	1.5%	-9.4%
Jo Buxhetorë	%	109%	60%	95%	35.7%	-14.1%

Krahasur me vitin 2013 rritja e arkëtimit është në masën 6.6%, ku rritjen më të madhe e ka segmenti familjar me 6.1% kundrejt faturimit.

Ndryshimi i menaxhimit dhe organizimi i ri i punës duke vendosur target e pergjegjësi tek të gjithë punonjësit e kompanisë solli edhe rritjen e lartë të arkëtimeve.

Edhe nëse krahasojmë vitin 2014 me 2012 që është edhe viti me arketimet më të mira gjatë administrimit të mëparshëm, përsëri kemi një përmirësim të ndjeshëm si më poshtë:

- Arkëtimet për faturat e energjisë janë rritur gjatë vitit 2014 edhe krahasuar me rezultatet e vitit 2012 për 1.2% ose 3.2 Miliard Lekë, por nëse marrim vetëm segmentet familjarë dhe privat rritja është akoma më e madhe.
- Rritja e lartë në segmentin familjar me 4.8% ose 2.3 Miliard lekë , që përbën edhe 55% te konsumit mujor, na lejon që të jemi optimist për realizimin e objektivave dhe ecurinë e kompanisë.
- Rritja është reflektuar si në arkëtimet për faturën korrente (brenda afatit) ashtu edhe për detyrimet e prapambetura.

Përmirësimi ka ardhur nga ndjekja sistematike e debitorëve duke përdorur:

- shtim të numrit të ndërprerjeve dhe target ditor për grupet e elektricistëve
- kontrolli ditor të planit të punës dhe grupeve në terren
- ndërhyrja në zona historikisht debitore për t'i kthyer drejt pagesës (kemi rritje arkëtimi në zonat veriore dhe periferitë e Tiranë, Durrës)
- plan për monitorim të ngushtë në shpërndarjen e faturës (shpërndarje në të gjitha zonat dhe brenda afatit)
- përmirësimi i kanaleve të pagesës, kalimi online i pagesave në arkat e OSHEE si dhe bankat kryesore

Departamenti Ekonomik

Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit

- fleksibilitet në mundësinë e pagesës, likujdim me këste të detyrimeve
- bllokim i shërbimeve për debitorët në bashkëpunim me institucionet shtetërore
- bashkëpunim me Task Forcën

1.6.3 Përmirësim në Menaxhimin e Rrjetit

Ka patur përmirësime dhe arritje në dy drejtimet kryesore:

- ✓ Është përmirësuar furnizimi me energji elektrike i konsumatorëve, duke siguruar furnizim me parametra teknike nominalë. Është rritur kontrolli dhe parandalimi i difekteve, shërbimi i paisjeve për t'i kthyer ato brenda kushteve teknike të shfrytëzimit, si dhe është realizuar zvogëlimi i kohës së eliminimit të difekteve duke bërë të mundur uljen e kohës që konsumatorët mbeten pa energji elektrike.

Kështu referuar të dhënave të treguesve të performancës, duke krahasuar rezultatet e vitit 2012 me ato të vitit 2013, SAIDI (koha gjatë së cilës konsumatorët mbeten pa energji) rezulton si më poshtë:

SAIDI	2012	7787 minuta
SAIDI	2013	7085 minuta

Pra kemi një ulje prej 9% të kohës që konsumatorët mbeten pa energji, për shkak të ndërprerjeve të planifikuara dhe difekteve të ndryshme në rrjet.

Duke vazhduar më tej, krahasuar periudhat Janar – Gusht 2013 me ato të vitit 2014, kemi përsëri përmirësim të treguesve në masën 20 % në vitin 2014, krahasuar me vitin 2013.

SAIDI	Janar - Gusht 2014	3811.79	minuta
SAIDI	Janar – Gusht 2013	4754.455	minuta

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit, ka ardhur si pasojë e mobilizimit të strukturave të mirëmbajtjes si në qendër dhe në bazë nëpërmjet kontrollit, kryerjes së shërbimeve dhe riparimit në kohë sa më të shkurtër të difekteve.

- ✓ Nëpërmjet sigurimit të bazës materiale për mirëmbajtjen , janë kryer remonte me tregues në rritje në sasi dhe cilësi të paisjeve të nënstacioneve dhe rrjetit shpërndarës TM/TU.

Për sa më sipër, për të gjitha Drejtoritë Rajonale Zonale u vendosën targetat e remonteve (remonte të mesme dhe profilaktike), të cilat përfshinë gjithë kabinat dhe rrjetin e shpërndarjes TM /TU në pronësi të OSHEE.

Departamenti Ekonomik

Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit

Sa më sipër realizimi i remonteve për periudhën Janar – Shtator 2014 është realizuar në masën 100 % për nënstacionet (paisjet + linjat 35 kV) si dhe mbi 80 % për kabinetat dhe 72 % për rrjetin TM/TU.

1.6.4 Përmirësime në Llogaritjen dhe Analizën e humbjeve

Një nga detyrat kryesore të kompanisë OSHEE sh.a. mbetet zvogëlimi i humbjeve teknike të fuqisë të DTL në të cilat përfshihen:

1. Humbjet në transformatorët e fuqisë,
2. Humbjet në rrjetat e tensionit të mesëm 6/10/35kV.

Niveli i humbjeve teknike të fuqisë në n/stacione në vite për kompaninë OSHEE sh.a. ka qënë në kufijtë (2.7 – 3)% . Konkretisht për vitin 2013 niveli i humbjeve ka qënë 2.86% në të njëjtin nivel me vitin 2012 megjithëse kemi patur një rritje të konsumit të energjisë elektrike në nivelin 3.5%.

Gjatë vitit 2013 e në vazhdim janë marrë një sërë masash për zvogëlimin e humbjeve teknike të DTL si:

- ✓ Evidentimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i konsumit të konsumatorëve privat të lidhur në rrjetin 35kV,
- ✓ Kontrolli i vazhdueshëm i energjisë së prodhuar nga HEC-et lokale të lidhur në rrjetin e shpërndarjes,
- ✓ Çkyçja nga rrjeti e transformatorëve të fuqisë në funksion të ngarkesës së n/stacionit në sezone të ndryshme të vitit,
- ✓ Vendosja e pikave të lidhjeve unazore në pika optimale si dhe punimi normal i fiderave të tensionit të mesëm me pikë unazore të hapur.
- ✓ Zevëndësimi i rrjetave të tensionit të mesëm 6/10kV me rrjet 20kV, si rrjeti shpërndarës i Ksamilit së bashku me kabinetat e transformacionit,
- ✓ Përmirësimi i rrjetit shpërndarës të zonës së Bregut (Borsh, Shën Vasil, etj) si dhe ndërtimi i n/stacionit në Sasaj-Bunec.
- ✓ Rikonstruksioni i linjës 35kV të Velipojës,
- ✓ Përmirësimi i sistemit të matjes të fiderave TM të n/stacioneve dhe linjave 35kV,

- ✓ Bashkërendimi i punës për zvogëlimin e humbjeve midis DTL me Drejtoritë Rajonale të Shpërndarjes.


1.6.5 Përmirësime në Marrëdhëniet me Klientët

Gjatë periudhës Janar – Shtator 2014 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013 kemi patur një rritje të nivelit të zgjidhjes së ankesave me 4300 raste. Gjithashtu nga viti 2013 janë trashëguar të pazgjidhura rreth 35% të ankesë/kërkesave të regjistruara, i cili ka ndikuar në uljen e rendimentit për zgjidhjen e rasteve brenda vitit 2014, të cilin e kemi aktualisht (3 muaj para se të mbyllet viti kalendarik), 50.6%.

Por në vlera progresive nga Janari – Shtator 2014, janë zgjidhur në total 66.2% të totalit 2013 - 2014 (50.6% të 2014 + 15.6% të 2013). Në vlera për periudhën Janar 2013 deri Shtator 2013 janë zgjidhur 57 816 ankesa e kërkesa, kundrejt 79 445 ankesa e kërkesa të zgjidhur gjatë periudhës Janar- Shtator 2014.

Më poshtë është pasqyruar grafiku me ankesë/kërkesat e regjistruara dhe ato të zgjidhura ndër vitet 2012-2014 (për periudhën Janar – Shtator) ku vihet re një rritje e nivelit të ankesë/kërkesave të regjistruara sidomos gjatë vitit 2014 si pasojë e mostrajtimit në kohë gjatë vitit të mëparshme.

Janar-Shtator	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014
Ankesa te reja	46,173	43,839	45,643
Kerkesa te reja	37,455	41,280	55,685
Total te regjistruara	83,628	85,119	101,328
Ankesa te zgjidhura	56,511	29,549	32,889
Kerkesa te zgjidhura	40,856	28,267	46,556
Total te zgjidhura	97,367	57,816	79,445



Departamenti Ekonomik

Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit

Rezultatet e arritura për 2014 kanë ardhur si pasojë e një kontrolli të vazhdueshëm ndaj strukturave të Drejtorisë së Marrdhënieve me Klientët dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimit.

Gjatë periudhës së administrimit të ri janë ndërmarrë një sërë masash për përmirësimin e situatës duke vënë një theks të rëndësishëm në drejtim të përshejtimit të procedurave për trajtimin e ankesë/kërkesave. Gjithashtu në objektivat e drejtorisë për mbylljen e 2014 kemi:

- Rritjen e shpejtësisë së zgjidhjes të ankesave
- Rritjen e cilësisë së trajtimit
- Uljen e kohës së trajtimit të ankesë/kërkesave që nga marrja deri në ekzekutim
- Përmirësimin e cilësisë së shërbimit në Qëndrat e Kujdesit ndaj Klientit
- Bashkëpunimin me drejtoritë e tjera në drejtim të rritjes së efektivitetit të punës
- Monitorimin në bazë ditore, javore, mujore të procesit të trajtimit të ankesë/kërkesave
- Monitorimin dhe kontrollin e stafit në të gjithë vendin duke rritur njohjen e situatës në terren
- Trajnim të vazhdueshëm të stafit për tu njohur me procedurat e reja

2. PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI

Hyrje:

Me anën e këtij dokumenti, paraqitet metodologjia e përdorur për parashikimin e zërave të Bilancit energjistik për periudhën rregullatore, duke vënë theksin tek rëndësia që ka parashikimi i saktë i kërkesës për energji, ne i kemi kushtuar një vëmendje të veçantë.

Duhet të theksojmë faktin se modeli statistikor i hartuar nga ne merr në konsideratë të gjithë parametrat që kanë impakt mbi rezultatet përfundimtare, duke ju përshtatur kështu sjelljes së konsumatorit Shqiptar kundrejt faktorëve të jashtëm.

2.1 Historiku i të dhënave

Historiku i të dhënave të përdorura për parashikimin e energjisë që do të injektohet në rrjetin e OSHEE dhe parashikimi i energjisë të faturuar për konsumatorët tariforë sipas kategorisë së tyre dhe nivelit ku janë lidhur në rrjet është marrë nga Bilanci Energjistik dhe Strukturat e shitjes përkatësisht për periudhën Janar 2009- Gusht 2014.

Duke u bazuar tek portofoli i klientëve që OSHEE furnizon me Energji Elektrike, historiku i të dhënave është pastruar nga klientët që nuk janë më pjesë e portofolit të OSHEE në mënyrë që të kemi një trend sa më të saktë për parashikim.

2.2 Metodologjia e Parashikimit të Energjisë së Injektuar në Rrjetin e OSHEE

Metodologjia e përdorur për këtë parashikim bazohet në trendin dhe sezonalitetin e profilit të sjelljes së konsumatorit në historikun e të dhënave. Gjithashtu janë marrë në konsideratë dhe variabla të tjerë, sic është plani që OSHEE ka për reduktimin e humbjeve për vitin 2015.

Energjia e injektuar në rrjetin e OSHEE përfshin energjinë për plotësimin e nevojave të klientëve dhe energjinë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e OSHEE.

Energjia e injektuar në rrjetin e OSHEE është shuma e energjisë së hyrë nga Operatori i Sitemit të Transmetimit (OST) dhe energjisë së prodhuar nga Hec-et private dhe me koncesion të lidhur ne rrjetin e OSHEE.

Në metodologjinë e parashikimit, Energjia e hyrë nga OST dhe Energjia e prodhuar e Hec-ve janë trajtuar si variabla të pavarur, sepse sjellja e tyre ndikohet nga faktorë të ndryshëm, si psh:

- Energjia e prodhuar nga Hec-et është e lidhur drejtpërdrejt me kushtet klimaterike (rreshjet) dhe numrin e Hec-ve lidhur në rrjetin e OSHEE.
- Energjia e hyrë nga OST në rrjetin e OSHEE varet nga ndryshimi i numrit të konsumatorëve të lidhur ne OSHEE dhe temperaturat.

Faktorët kryesorë ndikues në parashikimin e Energjisë së injektuar në rrjetin OSHEE janë:

- Numri i konsumatorëve
 - Parashikimi i GDP-se për 2015
 - Kushtet klimaterike
 - Plani i reduktimit të humbjeve.
 - Norma mesatare e ndryshimit të energjisë elektrike të injektuar gjatë periudhes 2009-2014
- $$k(1)_{inj} = (E_{2013} / E_{2009})^{(1/5)} - 1$$
- $$k(2)_{inj} = (E_{2014} / E_{2013}) - 1$$

Këtyre normave mesatare të ndryshimit ju japim përkatësisht peshat e rëndësisë duke u nisur nga rëndësia që kanë të dhënat më të afërta.

2.2.1 Energjia e injektuar e parashikuar për vitin 2015 është:

Energjia e injektuar e parashikuar për vitin 2015 është:

$$E_{inj2015} = E_{inj2014} * \text{average}(k(1)_{inj} * k_1, k(2)_{inj} * k_2) + E_{inj2014}$$

Ku:

Departamenti Ekonomik

Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit

E_{inj} = Energjie e injektuar ne rrjetin e OSHEE

k_{inj} = norma mesatare e ndryshimit

$k_1 \approx 0.4$

$k_2 \approx 0.6$

Në shumën totale të energjisë së parashikuar është marrë në konsideratë edhe impakti i të gjithë faktorëve të tjerë të sipërpërmëndur.

Pasi është parashikuar energjia vjetore e injektuar për vitin 2015, është bërë shpërndarja e saj sipas muajve. Kjo shpërndarje është bërë sipas peshës që zë cdo muaj në konsumin total të energjisë gjatë vitit. Këto pesha janë llogaritur në bazë të të dhënave historike, duke marre parasysh efektin e stinës në sjelljen e konsumit të energjisë nga njëri muaj në tjetrin.

2.2.2 Energjia e injektuar për çdo muaj

$$E_{inj(m)} = ave_k_{inj(m,i)} * E_{inj(2015)}$$

$$K_{inj(m)} = E_{inj(m)} / E_{inj(i)}$$

Ku:

$i = 2007..2014$

$m = \text{Janar}.. \text{Dhjetor}$

$ave_k_{inj(m,i)}$ = mesatarja e peshave të muajve në vite

2.3 Metodologjia e Parashikimit të Energjisë së Faturuar në Rrjetin e OSHEE për konsumatorët tariforë

2.3.1 Parashikimi i energjisë së faturuar për konsumatorët e lidhur në 35Kv

Në nivelin e tensionit 35 kv parashikimi është bërë në bazë kategorish (industri, tregti dhe shërbime, bujqësi, të tjerë) sipas strukturës së shitjes duke analizuar të dhënat historike për këto kategori. Të dhënat historike që janë përdorur janë energjia e faturuar prej vitit Janar 2010 deri Gusht 2014.

Për parashikimin e muajve të mbetur të vitit 2014 është llogaritur mesatarja e koeficientëve të ndryshimit për cdo muaj duke i dhënë peshë historikut të viteve më të fundit, përkatësisht sipas koeficientëve:

$k_1 = 0.5$ për vitin 2013-2012

$k_2 = 0.3$ për vitin 2012-2011

$k_3 = 0.2$ për vitin 2011-2010

$$koef_{ij} = average((kon_{i,j-1} / kon_{i,j-2} - 1) * k_1, ((kon_{i,j-2} / kon_{i,j-3} - 1) * k_2, (kon_{i,j-3} / kon_{i,j-4} - 1) * k_3)$$

Departamenti Ekonomik

Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit

Formulat për parashikimin e muajve të mbetur të vitit 2014 sipas kategorisë:

1-Industri

$$kon(I)_{ij} = koef_{ij} * kon_{i,j-1} + kon_{i,j-1}$$

-Tregti dhe shërbime

$$kon(T.sh)_{ij} = koef_{ij} * kon_{i,j-1} + kon_{i,j-1}$$

-Të tjerë

$$kon(T.t)_{ij} = koef_{ij} * kon_{i,j-1} + kon_{i,j-1}$$

-Totali i energjisë së faturuar për muajt Shtator-Dhjetor 2014 në 35kv

$$kon(35kv)_{ij} = kon(I)_{ij} + kon(T.sh)_{ij} + kon(T.t)_{ij}$$

Ku :

$i = \text{Shtator} - \text{Dhjetor}$

$j = 2014$

2.3.2 Formulat për parashikimin e vitit 2015 sipas kategorisë:

Për parashikimin e vitit 2015 është llogaritur mesatarja e koeficientëve të ndryshimit për cdo muaj duke i dhënë peshë historikut të viteve më të fundit, përkatësisht sipas koeficientëve:

$k_1 = 0.5$ për vitin 2014-2013

$k_2 = 0.3$ për vitin 2013-2012

$k_3 = 0.2$ për vitin 2012-2011

$$koef_{ij} = average((kon_{i,j-1} / kon_{i,j-2} - 1) * k_1, ((kon_{i,j-2} / kon_{i,j-3} - 1) * k_2, (kon_{i,j-3} / kon_{i,j-4} - 1) * k_3)$$

Në llogaritjen e parashikimit të konsumit të muajve të vitit 2015 sipas kategorive kemi përdorur:

-industri

$$kon(I)_{ij} = average(koef_{1,j}, koef_{2,j}, \dots, koef_{12,j}) * kon_{i,j-1} + kon_{i,j-1}$$

-Tregti dhe shërbime

$$kon(T.sh)_{ij} = average(koef_{1,j}, koef_{2,j}, \dots, koef_{12,j}) * kon_{i,j-1} + kon_{i,j-1}$$

-Të tjerë

$$kon(T.t)_{ij} = average(koef_{1,j}, koef_{2,j}, \dots, koef_{12,j}) * kon_{i,j-1} + kon_{i,j-1}$$

- Totali i energjisë së faturuar për muajt Janar- Dhjetor 2015 në 35kv

$$kon(35kv)_{ij} = kon(I)_{ij} + kon(T.sh)_{ij} + kon(T.t)_{ij}$$

Departamenti Ekonomik
Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit

Ku :

$i = \text{Janar} - \text{Dhjetor}$

$j = 2015$

2.4 Parashikimi i energjisë së faturuar për konsumatorët e lidhur në 20/10/6 Kv

Në nivelin e tensionit 20/10/6 kv parashikimi është bërë në bazë kategorish (industri, tregti dhe shërbime, prodhim mielli dhe furra buke, bujqësi, të tjerë, buxhetor) sipas strukturës së shitjes duke analizuar të dhënat historike për këto kategori. Të dhënat historike që janë përdorur janë energjia e faturuar prej vitit 2009 deri Gusht 2014.

Formulat për parashikimin e muajve të mbetur të vitit 2014 sipas kategorisë:

Është llogaritur mesatarja e koeficientëve të ndryshimit për çdo muaj duke i dhënë peshë historikut të viteve më të fundit, përkatësisht sipas koeficientëve:

$k_1 = 0.4$ për vitin 2013-2012

$k_2 = 0.3$ për vitin 2012-2011

$k_3 = 0.2$ për vitin 2011-2010

$k_4 = 0.1$ për vitin 2010-2009

$$koef1_{ij} = average((kon_{i,j-1} / kon_{i,j-2} - 1) * k_1, ((kon_{i,j-2} / kon_{i,j-3} - 1) * k_2, \dots \\ \dots (kon_{i,j-3} / kon_{i,j-4} - 1) * k_3, (kon_{i,j-3} / kon_{i,j-4} - 1) * k_4)$$

Ku :

$i = \text{Shtator} - \text{Dhjetor}$

$j = 2014$

Llogarisim mesataren e koeficientit të ndryshimit duke përdorur edhe faktiket Janar-Gusht 2014

$$koef2_{ij} = average((kon_{i,j-1} / kon_{i,j-2} - 1) * k_1, ((kon_{i,j-2} / kon_{i,j-3} - 1) * k_2, \dots \\ \dots (kon_{i,j-3} / kon_{i,j-4} - 1) * k_3, (kon_{i,j-3} / kon_{i,j-4} - 1) * k_4)$$

Ku :

$i = \text{Janar} - \text{Gusht}$

$j = 2015$

Faturimi i parashikuar për muajt e mbetur të vitit 2014 duke përdorur koeficientët e mësipërm, duke i dhënë $koef1_{ij} = koef1_{2013}$ peshën 0.4 dhe $koef2_{ij} = koef2_{2014}$ peshën 0.6, kjo për ti dhënë më shumë rëndësi periudhës më të afërt.

Departamenti Ekonomik

Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit

$$kon(I)_{ij} = average(koef_{2_{2014}} * 0.6, koef_{1_{2013}} * 0.4) * kon_{i,j-1} + kon_{i,j-1}$$

Ku :

i = Shtator – Dhjetor

j = 2014

Faturimi i parashikuar për muajt e vitit 2015 është:

-Industri

$$kon(I)_{ij} = average(koef_{1,j}, koef_{2,j}, \dots, koef_{12,j}) * kon_{i,j-1} + kon_{i,j-1}$$

$$koef_{i,j} = average((kon_{i,j-1} / kon_{i,j-2} - 1) * k_1, ((kon_{i,j-2} / kon_{i,j-3} - 1) * k_2, \dots \\ \dots (kon_{i,j-3} / kon_{i,j-4} - 1) * k_3, (kon_{i,j-3} / kon_{i,j-4} - 1) * k_4)$$

Ku:

i = Janar – Dhjetor

j = 2015

E njëjta mënyrë parashikimi është përdorur për kategoritë e tjera (tregti dhe shërbime, prodhim mielli dhe furra buke, bujqësi, të tjerë, buxhetor) në këtë nivel tensioni, duke theksuar se në parashikim është marrë në konsideratë dhe “sheshimi ” i të dhënave që prishin trendin.

Energjia totale e parashikuar për vitin 2015 në nivelin 20/10/6 kv është shuma e energjisë së parashikuar për çdo kategori në këtë nivel tensioni.

2.5 Parashikimi i energjisë së faturuar për nivelin e tensionit 0.4 kv

Në këtë nivel tensioni vihet re një korrelacion midis numrit të konsumatorëve dhe energjisë së faturuar. Për këtë arsye parashikimi i energjisë së faturuar për kategoritë jofamiljare në këtë nivel tensioni është parashikuar në lidhje me evoluimin e trendit të konsumatorëve.

Të dhënat historike të përdorura janë nga Janar 2012 deri Gusht 2014 pasi lidhja e numrit të konsumatorëve me konsumin është më aktuale për tu bazuar në parashikimin e energjisë së faturuar për vitin 2015. Gjejmë konsumin mesatar për konsumator në çdo kategori:

$$kon_{mes(k,j,i)} = Nr_{i,j,k} / Kon_{i,j,k}$$

Ku:

K=kategoritë

i =muajt

j = viti

Departamenti Ekonomik
Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit

Totali i kategorive:

$$T.Nr_{i,j,k} = \sum Nr_{k,i,j}$$

$$T.Kon_{i,j,k} = \sum Kon_{k,i,j}$$

$$T.kon_{mes(i,j,k)} = T.Nr_{i,j} / T.Kon_{i,j}$$

Ku:

K=kategoritë

i =muajt

j = viti

Meqënëse konsumi i këtyre kategorive ka lidhje me sezonalitetin është bërë grupimi një në tre mujore të tillë:

Për numrin e konsumatorëve:

$$Q_j = average(Nr_{i,j}, Nr_{i+1,j}, Nr_{i+2,j})$$

Për energjinë e faturuar:

$$Q_j = sum(Kon_{i,j}, Kon_{i+1,j}, Kon_{i+2,j})$$

Ku:

$j = 1-4$ (Q_1, Q_2, Q_3, Q_4)

$i = 1-3$ (muajt e tremujorit përkatës)

Për parashikimin e energjisë së faturuar për gjithë kategoritë jofamiljare të tremujorëve të mbetur të vitit 2014 dhe të vitit 2015 përdorim konsumin mesatar të parashikuar me anë të funksionit Logaritmik dhe numrit të prishëm të konsumatorëve.

2.5.1 Parashikimi i energjisë së faturuar për tremujorët e mbetur të vitin 2014:

$$T.Nr.Q_{i+1,j} = T.Nr.Q_{i,j} + 4402$$

$$kon_{mes} Q_{i+1,j} = growth(Kon.Mes_{2012,2014}, (1-10))$$

Ku:

4402 është: mesatarja e rritjes së 3 tremujorëve të fundit të numrit të konsumatorëve

$i = 2-3$

$j = 2014$

Në këtë mënyrë energjia e faturuar sipas tremujoreve është:

$$Q_{i,j} = T.Nr_{i,j} * kon_{mes} Q_{i,j}$$

Ku:

$i=3-4$

$j=2014$

Shuma e dy tremujorëve të parashikuar jep parashikimin e energjisë së faturuar për mbylljen e vitit 2014.

Edhe për parashikimin e energjisë së faturuar për tremujorët e vitit 2015 vazhdohet në të njejtën menyrë.

Si rezultat nga shuma e të katërt tremujorëve të parashikuara marrim energjinë totale të parashikuar për vitin 2015 për kategoritë jofamiljare në 0.4 kv.

Për të parashikuar energjinë e faturuar dhe numrin e konsumatorëve sipas kategorive jofamiljare bëjmë ndarjen sipas peshave specifike të tyre ndaj totalit nga të dhënat faktike.

Për ndarjen e totalit të parashikuar sipas muajve dhe kategorive janë përdorur peshat specifike për këto ndarje.

2.6 Konsumatorët Familjarë

Kategoria e konsumatorëve familjarë është trajtuar më vete, duke ndërtuar një metodologji që i përshtatet kurbës së konsumit për këta konsumatorë. Nga historiku i të dhënave është parë se ekziston një korrelacion i fortë midis konsumit familjar, temperaturave dhe numrit të konsumatorëve, ndaj është përdorur lidhja midis këtyre tre variablove.

Në analizë janë marrë të dhënat historike për konsumin, temperaturat dhe numrin e konsumatorëve nga viti 2009 deri në Gusht 2014.

Për temperaturat është përdorur koncepti i HDD dhe CDD, ne përdorëm modelin e krijuar nga Kevin Baumert dhe Mindy Selman i quajtur “Shkalla e ditëve për ngrohje dhe ftohje” (Heating and Cooling Degree Days”)

2.7 Metodologjia e përdorur për llogaritjen e Grad ditët

Për parashikimin e konsumit afatgjatë të familjarëve të cilët ndikohen nga temperaturat kemi përdorur konceptin HDD (heating degree days) dhe CDD (cooling degree days). HDD dhe CDD maten në gradë ditë që shprehin shmangien mesatare të një temperature ndaj temperaturës bazë, ku supozohet që nuk ka nevojë për ngrohje apo ftohje. HDD përfaqëson se sa gradë ditë temperatura mesatare ditore është nën temperaturën bazë dhe CDD përfaqëson se sa gradë ditë temperatura mesatare ditore është mbi temperaturën bazë. Si temperaturë bazë përdorim 18 °C, dhe HDD llogaritet 18-T dhe CDD llogaritet si T-18, ku T është temperatura mesatare ditore. HDD dhe CDD vjetore, llogariten si shumë e HDD dhe CDD ditore për një vit.

Si alternativë në mungesë të të dhënave për llogaritjen e HDD dhe CDD me bazë ditore kemi përdorur mesataren mujore të temperaturës. Kur përdorim temperaturë mesatare mujore atëherë HDD dhe CDD llogariten me formulën $D_m(18-T_a)$ për HDD dhe $D_m(T_a-18)$ për CDD ku D_m është numri i ditëve të muajit dhe T_a është temperatura mesatare ditore. Për shkak se kjo metodë nuk merr parasysh ndryshueshmërinë e temperaturës brenda muajit, ajo ka të ngjarë të mbi apo nënvleresojë nevojat për ngrohje dhe ftohje. Për të kompensuar këtë, llogaritet devijimi standart i temperaturës mesatare mujore rreth mesatares vjetore (σ_y) dhe mesatares ditore rreth mesatares mujore, (σ_m).

Nga ana e tij, devijimi standard i temperaturave mesatare ditore rreth mesatares mujore përdoret për të vlerësuar ndryshueshmërinë e temperaturës mesatare ditore brenda muajit.

HDD dhe CDD për muajin mund të llogariten si:

$$DD_m = \sigma_m(D_m)^{1.5} [h/2 + \ln(e^{-ah} + e^{ah})/2a]$$

Ku:

$$h = (T_{base}-T_a)/[\sigma_m (D_m)^{1/2}] \quad (\text{llogaritja për "shkallët" që kemi nevoja për ngrohje),}$$

$$h = (T_a-T_{base})/[\sigma_m (D_m)^{1/2}] \quad (\text{llogaritja për "shkallët" që kemi nevoja për ftohje),}$$

$$a = 1.698(D_m)^{1/2},$$


$$\sigma_m = 1.45 - 0.29T_a + 0.664\sigma_y.$$

Aplikimi i HDD dhe CDD për parashikimin e konsumit vjetor bëhet duke marrë parasysh edhe peshën e klientëve (konsumin e energjisë për klient) dhe lidhjen midis këtij konsumi me HDD dhe CDD. Në parashikim bëhet edhe një përlllogaritje e numrit të pritsëm të konsumatorëve (rritje vjetore) për periudhën që po parashikojmë.


Llogaritja e HDD dhe CDD për Shqipërinë është bërë duke marrë parasysh shtrirjen gjeografike të Shqipërisë sipas 13 zonave (Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Fieri, Kukës, Laç, Burrel, Korçë, Berat, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër), duke llogaritur kështu indeksin për ngrohje dhe ftohje për secilën nga këto qytete: këto indekse u përdorën për parashikimn e konsumit për kategorinë familjar të ndarë në dy blloqe: në bllokun e parë më të vogël/baraz me 300 KWh dhe në bllokun e dytë mbi 300 KWh.

Në grafikun e më poshtëm paraqiten grafiksht mesatarja historike e HDD dhe CDD për vitet 2009-2014 dhe sipas zonave.

Departamenti Ekonomik
Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit



grafiku 1



grafiku 2

Metodologjinë origjinale mund ta gjeni bashkëngjitur në shtojcën në fund të këtij materiali ose në linkun e mëposhtëm:

<https://www.scribd.com/doc/34318847/Degree-Days>

Pasi llogritëm HDD dhe CDD për të dhënat historike kemi llogaritur “shkallët” që kemi nevojë për ngrohje apo ftohje për vitin 2015 të cilat janë paraqitur në *grafikun 1*.

Departamenti Ekonomik

Drejtoria e Planifikim Kontrollit dhe Raportimit

Më pas kemi llogaritur konsumin mesatar për secilin bllok duke u nisur nga numri i konsumatorëve dhe nga DD konsumi si më poshtë:

Konsumi mesatar për bllokun e parë mbi numër konsumatorësh ,

$$k_{\text{mes} \leq 300} = \frac{k_{\text{mes} \leq 300}}{nr_{\leq 300}}$$

Konsumi mesatar për bllokun e dytë mbi numër konsumatorësh ,

$$k_{\text{mes} > 300} = \frac{k_{\text{mes} > 300}}{nr_{> 300}}$$

Raporti i Konsumit mesatar për bllokun e parë mbi shkallë DD ,

$$k(1)_{ij} = \frac{k_{m \leq 300}}{N_{DD}}$$

Raporti i Konsumit mesatar për bllokun e dytë mbi shkallë DD ,

$$k(2)_{ij} = \frac{k_{m > 300}}{N_{DD}}$$

Llogarisim “shkallën” vjetore për DD për periudhën 2009-2015

$$DD_i = \text{average}(d_{i,j}, d_{i,j-1}, d_{j-3}, d_{i,j-4}, d_{i,j-5}, d_{i,j-6}, d_{i,j-7})$$

Ku:

d_{ij} shuma e HDD dhe CDD sipas zonave për muajin përkatës

$i = \text{janar} - \text{dhjetor}$

$j = 2009 - \text{gusht } 2014$

Më pas llogarisim:

konsumin për një klient për bllokun e parë

$$Kons_{(klient)_i} = DD_i * \text{average}(k(1)_{ij})$$

Ku:

$i = \text{janar} - \text{dhjetor}$

$j = 2009 - \text{gusht } 2014$

Konsumi për një klient për bllokun e dytë


$$Kons_{(klient)_i} = DD_i * \text{average}(k(2)_{ij})$$

Ku:

$i = \text{janar} - \text{dhjetor}$

$j = 2009 - \text{gusht } 2014$

Numri i prithshëm i konsumatorëve familjarë është bazuar mbi historikun e lidhjeve të reja . Ne presim të lidhen 3 500 konsumatorë familjarë të rinj dhe 10 500 konsumatorë për 2015.



Ky numër konsumatorësh i pritshëm për vitin 2014 dhe 2015 është ndarë sipas dy blloqeve të konsumit sipas muajve duke marrë parasysh peshën secilit bllok në muajin përkatës.

Parashikimi për muajt Shtator – Dhjetor 2014:

$$Nr_{(total)ij} = Nr_{i,j-1} + 3500 / 4$$

Ku:

$i = \text{shtator} - \text{dhjetor}$

$j = 2014$

Ndarja konsumatorëve në bllokun e parë dhe të dytë Shtator – Dhjetor 2014:

$$Nr_{(\leq 300)ij} = \frac{Nr_{(\leq 300)i,j-1}}{Nr_{(total)i,j-1}} Nr_{(total)ij}$$

Ku:

$i = \text{shtator} - \text{dhjetor}$

$j = 2014$

Nr i konsumatorëve për bllokun tjetër është llogaritur si diferencë e nr total të parashikuar me nr e konsumatorëve të vlerësuar për bllokun e parë.
